



**INSTITUTI PËR  
SHKENCË DHE ARTE**  
UNIVERSITETI HAXHI ZEKA

# **HULUMTIM PËR PUNËSUESHMËRINË DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË TË DIPLOMUARVE (ALUMNI)**

***INSTITUTI PËR SHKENCË DHE ARTE  
UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" - PEJË***

**UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” - PEJË**



**INSTITUTI PËR SHKENCË DHE ARTE**



**INSTITUTI PËR  
SHKENCË DHE ARTE**  
UNIVERSITETI HAXHI ZEKA

# **HULUMTIM PËR PUNËSUESHMËRINË DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË TË DIPLOMUARVE (ALUMNI)**

**Raport i hartuar nga Instituti për Shkencë dhe Arte**

*Pejë, Maj 2026*

**© Të gjitha të drejtat për përdorimin e raportit janë të rezervuara ekskluzivisht për  
Institutin për Shkencë dhe Arte, Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë**

# PËRMBAJTJA

|                                |    |
|--------------------------------|----|
| LISTA E TABELAVE.....          | 5  |
| LISTA E FIGURAVE .....         | 6  |
| LISTA E GRAFIKËVE .....        | 6  |
| LISTA E SHKURTESAVE.....       | 7  |
| HYRJE .....                    | 8  |
| METODOLOGJIA E HULUMTIMIT..... | 11 |
| Kalkulimi i mostrës.....       | 14 |
| REZULTATET DHE DISKUTIMI ..... | 16 |
| KONKLUZIONE .....              | 55 |
| DHE REKOMANDIME .....          | 55 |
| SHTOJCË.....                   | 58 |

## LISTA E TABELAVE

|   |    |
|---|----|
| Tabela 1. Shpjegimi i simboleve të formulës.....  | 14 |
| Tabela 2. Vlerat e shkallëve z .....  | 15 |
| Tabela 3. Gjinia e të anketuarve .....  | 17 |
| Tabela 4. Viti i diplomimit të të anketuarve.....   | 18 |
| Tabela 5. Niveli i studimeve të përfunduara .....   | 19 |
| Tabela 6. Programi i studimeve / Departamenti .....   | 20 |
| Tabela 7. Vendi aktual i banimit .....  | 21 |
| Tabela 8. Vendbanimi jashtë Kosovës.....  | 22 |
| Tabela 9. Statusi aktual i punësimit.....   | 23 |
| Tabela 10. Raporti “të punësuar - të papunësuar” .....  | 24 |
| Tabela 11. Sa kohë pas diplomimit e keni gjetur punën e parë? .....   | 25 |
| Tabela 12. Sektori i punësimit të të anketuarve.....  | 26 |
| Tabela 13. Pozita ose titulli i vendit të punës.....  | 28 |
| Tabela 14. Lloji i ndërmarrjes ku janë të punësuar të anketuarit.....   | 30 |
| Tabela 15. A është puna juaj aktuale në fushën për të cilën keni diplomuar? .....                                       | 31 |
| Tabela 16. Fusha e punësimit kundrejt fushës së studimit të të anketuarve që janë punësuar në fushë tjetër .....        | 32 |
| Tabela 17. Sa i rëndësishëm ishte niveli i arsimit tuaj universitar për të siguruar punën aktuale?.....                 | 33 |
| Tabela 18. Sa e vlerësoni përgatitjen profesionale që keni fituar gjatë studimeve? .....                                | 34 |
| Tabela 19. Në cilat fusha mendoni se universiteti mund të përmirësohet për të rritur punësueshmërinë e studentëve?..... | 35 |
| Tabela 20. A keni marrë pjesë në ndonjë praktikë profesionale gjatë studimeve?.....                                     | 37 |
| Tabela 21. Nëse po, sa e dobishme ishte për përgatitjen tuaj profesionale?.....   | 38 |
| Tabela 22. A do ta rekomandonit programin tuaj të studimit tek të tjerët? .....   | 38 |
| Tabela 23. Cilat aftësi të fituara në UHZ i përdorni më së shumti në punën tuaj? .....                                  | 40 |
| Tabela 24. Niveli i të ardhurave mujore .....   | 42 |
| Tabela 25. A jeni ngritur në detyrë pas punësimit të parë? .....  | 43 |
| Tabela 26. Niveli i qëndrueshmërisë së marrëdhënies së punës.....   | 44 |
| Tabela 27. A keni ndjekur ndonjë trajnim / kurs pas diplomimit? .....   | 45 |
| Tabela 28. A planifikoni të vazhdoni studimet e mëtejshme (Master / PhD)?.....  | 46 |
| Tabela 29. Cilat aftësi mendoni se janë më të kërkuara nga punëdhënësit? .....  | 47 |
| Tabela 30. Sfidat kryesore për t’u punësuar.....  | 49 |
| Tabela 31. Si mund të përmirësojë universiteti mbështetjen për studentët dhe ALUMNI-t në tregun e punës? .....          | 51 |

## LISTA E FIGURAVE

|  |    |
|--|----|
| Figura 1. Fazat e realizimit të hulumtimit ..... | 13 |
|--|----|

## LISTA E GRAFIKËVE

|   |    |
|---|----|
| Grafiku 1. Gjinia e të anketuarve .....   | 17 |
| Grafiku 2. Viti i diplomimit të të anketuarve .....   | 18 |
| Grafiku 3. Niveli i studimeve të përfunduara .....  | 19 |
| Grafiku 4. Programi i studimeve / Departamenti .....  | 21 |
| Grafiku 5. Vendi aktual i banimit .....   | 22 |
| Grafiku 6. Vendbanimi jashtë Kosovës .....  | 23 |
| Grafiku 7. Statusi aktual i punësimit .....   | 24 |
| Grafiku 8. Raporti “të punësuar - të papunësuar” .....  | 25 |
| Grafiku 9. Sa kohë pas diplomimit e keni gjetur punën e parë? .....   | 26 |
| Grafiku 10. Sektori i punësimit të të anketuarve .....  | 27 |
| Grafiku 11. Pozita ose titulli i vendit të punës .....  | 29 |
| Grafiku 12. Lloji i ndërmarrjes ku janë të punësuar të anketuarit .....   | 30 |
| Grafiku 13. A është puna juaj aktuale në fushën për të cilën keni diplomuar? .....  | 31 |
| Grafiku 14. Sa i rëndësishëm ishte niveli i arsimit tuaj universitar për të siguruar punën aktuale? .....                 | 33 |
| Grafiku 15. Sa e vlerësoni përgatitjen profesionale që keni fituar gjatë studimeve? .....                                 | 34 |
| Grafiku 16. Në cilat fusha mendoni se universiteti mund të përmirësohet për të rritur punësueshmërinë e studentëve? ..... | 36 |
| Grafiku 17. A keni marrë pjesë në ndonjë praktikë profesionale gjatë studimeve? .....                                     | 37 |
| Grafiku 18. Nëse po, sa e dobishme ishte për përgatitjen tuaj profesionale? .....   | 38 |
| Grafiku 19. A do ta rekomandonit programin tuaj të studimit tek të tjerët? .....  | 39 |
| Grafiku 20. Cilat aftësi të fituara në UHZ i përdorni më së shumti në punën tuaj? .....                                   | 41 |
| Grafiku 21. Niveli i të ardhurave mujore .....  | 42 |
| Grafiku 22. A jeni ngritur në detyrë pas punësimit të parë? .....   | 43 |
| Grafiku 23. Niveli i qëndrueshmërisë së marrëdhënies së punës .....   | 44 |
| Grafiku 24. A keni ndjekur ndonjë trajnim / kurs pas diplomimit? .....  | 45 |
| Grafiku 25. A planifikoni të vazhdoni studimet e mëtejshme (Master / PhD)? .....  | 46 |
| Grafiku 26. Cilat aftësi mendoni se janë më të kërkuara nga punëdhënësit? .....   | 48 |

## LISTA E SHKURTESAVE

|        |   |
|--------|---|
| UHZ    | Universiteti "Haxhi Zeka"                       |
| ISHA   | Instituti për Shkencë dhe Arte                  |
| AA     | Agromjedis dhe Agroekologji                     |
| AB     | Administrim Biznesi                             |
| AK     | Administrativ Kushtetues                        |
| EAI    | Edukim Artistik në Intepretim                   |
| EDNE   | E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane            |
| EM     | Edukim në Muzikë                                |
| IAB    | Informatikë e Aplikuar në Biznes                |
| IB     | Informatika në Biznes                           |
| JP     | Juridik i Përgjithshëm                          |
| JPN    | Juridiko-Penal                                  |
| KF     | Kontabilitet dhe Financa                        |
| MB     | Menaxhim Biznesi                                |
| MB: BF | Menaxhim Biznesi: Banka dhe Financa             |
| MB: KA | Menaxhim Biznesi: Kontabilitet dhe Auditim      |
| MBNJ   | Menaxhim i Burimeve Njerëzore                   |
| MM     | Menaxhim Mjedis                                 |
| MTQ    | Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm              |
| MTHM   | Menaxhim në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis       |
| SQPU   | Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimit |
| TPB    | Teknologjia e Prodhimit Bimor                   |
| TU     | Teknologji Ushqimore                            |

**HYRJE**

Në një treg pune gjithnjë e më dinamik dhe konkurrues, punësueshmëria e të diplomuarve përbën një nga indikatorët kryesorë të cilësisë së arsimit të lartë dhe relevancës së tij ndaj nevojave të shoqërisë dhe ekonomisë. Në këtë kontekst, institucionet e arsimit të lartë përballen me kërkesën për të qenë më fleksibile, inovative dhe të orientuara drejt rezultateve konkrete në zhvillimin e kapitalit njerëzor. Ndryshimet e shpejta teknologjike, globalizimi dhe transformimet në strukturën e tregut të punës kanë rritur nevojën për profile profesionale të pajisura jo vetëm me njohuri teorike, por edhe me aftësi praktike, kritike dhe ndërdisiplinore.

Universitetet, përveç rolit të tyre tradicional në ofrimin e njohurive teorike, kanë një përgjegjësi të shtuar për të përgatitur studentët me aftësi praktike, kompetenca profesionale dhe fleksibilitet të mjaftueshëm për t'u integruar me sukses në tregun e punës. Kjo nënkupton një qasje më të integruar të procesit mësimor, ku teoria dhe praktika ndërthuren në mënyrë efektive, duke mundësuar zhvillimin e aftësive të transferueshme si komunikimi, puna në grup, zgjidhja e problemeve dhe përdorimi i teknologjisë. Për më tepër, bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat, përfshirja e praktikave profesionale, si dhe krijimi i mekanizmave funksionalë mbështetës për studentët dhe të diplomuarit, konsiderohen elemente kyçe në rritjen e punësueshmërisë dhe në lehtësimin e tranzicionit drejt punësimit.

Në këtë kuadër, roli i universiteteve shtrihet edhe përtej periudhës së studimeve, duke përfshirë mbështetjen për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të të diplomuarve dhe krijimin e rrjeteve bashkëpunuese që kontribuojnë në shkëmbimin e përvojave dhe mundësive të punësimit. Kjo kërkon zhvillimin e strategjive institucionale të mirëstrukturuara, të cilat synojnë forcimin e lidhjes ndërmjet arsimit dhe tregut të punës, si dhe rritjen e ndikimit të universiteteve në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Ky hulumtim ka për qëllim të analizojë punësueshmërinë e të diplomuarve të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë (UHZ), duke u fokusuar në aspektet kryesore që lidhen me tranzicionin nga studimet në tregun e punës. Studimi synon të trajtojë dimensione të ndryshme të këtij procesi, duke përfshirë faktorët që ndikojnë në integrimin profesional, rolin e përgatitjes akademike dhe perceptimet e të diplomuarve mbi sfidat dhe mundësitë që hasin në rrugëtimin e tyre profesional. Përmes këtij qasjeje, synohet të krijohet një pasqyrë e plotë dhe e strukturuar mbi situatën aktuale dhe potencialin për zhvillim.

Për më tepër, ky hulumtim kontribuon në identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim në kuadër të politikave dhe praktikave institucionale, duke ofruar një bazë të qëndrueshme për vendimmarrje dhe planifikim strategjik. Ai synon të nxisë reflektim

institucional mbi mënyrën e përmirësimit të cilësisë së programeve studimore, përditësimit të kurrikulave dhe rritjes së efektivitetit të mekanizmave mbështetës për studentët dhe të diplomuarit.

Në këtë mënyrë, rezultatet e këtij hulumtimi pritet të shërbejnë si një bazë e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të programeve studimore, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe forcimin e lidhjes ndërmjet universitetit dhe tregut të punës. Në thelb, ky studim synon të kontribuojë në rritjen e punësueshmërisë dhe suksesit profesional të gjeneratave të ardhshme, duke e pozicionuar universitetin si një aktor të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

# **METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Ky hulumtim është realizuar duke përdorur një qasje kuantitative, me qëllim analizimin e punësueshmërisë së të diplomuarve të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë. Kjo qasje është zgjedhur për shkak të aftësisë së saj për të mundësuar mbledhjen dhe analizimin sistematik të të dhënave, si dhe për nxjerrjen e përfundimeve të përgjithësuara mbi fenomenin e studiuar.

Popullata e synuar e këtij hulumtimi përfshin të gjithë të diplomuarit e universitetit ndër vite. Fillimisht është siguruar një listë me rreth 6200 të diplomuar. Megjithatë, gjatë procesit të përgatitjes së bazës së të dhënave është konstatuar se rreth 1200 prej tyre nuk kishin adresë elektronike të evidentuar ose e kishin të pasaktë, duke e reduktuar numrin e kontakteve valide në rreth 5000.

Në fazën e shpërndarjes së pyetësorit, është vërejtur se rreth 20% e emailave të mbetur nuk kanë qenë funksionale (për shkak të adresave të deaktivizuara ose mungesës së hapësirës për pranimin e mesazheve), çka ka ndikuar në kufizimin e arritjes së plotë të popullatës. Si rezultat, mostra efektive e kontaktuar për këtë hulumtim ka përfshirë rreth 4000 të diplomuar, të cilëve u është dërguar pyetësori përmes formave online, kryesisht nëpërmjet emailit dhe platformave të tjera digjitale.

Mbledhja e të dhënave është realizuar përmes një pyetësori të strukturuar, i cili ka përfshirë pyetje të mbyllura dhe gjysmë të hapura. Pyetësori është dizajnuar për të mbledhur informacione mbi karakteristikat demografike të të anketuarve, nivelin dhe fushën e studimit, statusin aktual të punësimit, kohën e gjetjes së punës së parë, sektorin e punësimit, si dhe perceptimet mbi përgatitjen profesionale dhe kërkesat e tregut të punës.

Në total, në hulumtim kanë marrë pjesë 365 të diplomuar, të cilët përbëjnë mostrën përfundimtare të analizës. Kjo mostër përfaqëson një gamë të gjerë profilesh akademike dhe profesionale, duke përfshirë nivele të ndryshme studimi (Bachelor dhe Master) dhe fusha të ndryshme të specializimit.

Përpunimi dhe analiza e të dhënave janë realizuar duke përdorur metoda statistikore deskriptive, përmes të cilave janë paraqitur frekuencat dhe përqindjet për secilën variabël të studiuar. Rezultatet janë prezantuar në formë tabelare dhe janë interpretuar në mënyrë analitike, me qëllim ofrimin e një pasqyre të qartë dhe të strukturuar të situatës së të diplomuarve në tregun e punës.

Sa i përket kufizimeve të studimit, duhet theksuar se përdorimi i pyetësorit online dhe vetë-raportimi i të dhënave mund të ndikojnë në subjektivitetin e përgjigjeve. Gjithashtu, kufizimet në arritjen e plotë të popullatës dhe natyra vullnetare e pjesëmarrjes mund të

ndikojnë në nivelin e përgjithësimin të rezultateve. Megjithatë, madhësia e mostrës dhe shpërndarja e saj në fusha të ndryshme kontribuojnë në rritjen e besueshmërisë dhe relevancës së gjetjeve.

Në përgjithësi, metodologjia e ndjekur ofron një bazë të qëndrueshme për analizimin e punësueshmërisë së të diplomuarve dhe për formulimin e rekomandimeve të dobishme për zhvillimin e mëtejshëm institucional.

Figura 1. Fazat e realizimit të hulumtimit



## Kalkulimi i mostrës

Në këtë seksion paraqitet përcaktimi i madhësisë së mostrës përmes formulës përkatëse statistikore, duke u bazuar në madhësinë e popullatës së përgjithshme dhe në parametrat standard të kërkimit, si niveli i besueshmërisë dhe marzhi i gabimit. Përmes kësaj formule është llogaritur numri minimal i respondentëve të nevojshëm për të siguruar rezultate të besueshme dhe të përfaqësueshme. Ky proces siguron që të dhënat e mbledhura të kenë bazë të qëndrueshme statistikore dhe të jenë të përshtatshme për analizë dhe interpretim.

$$\text{Madhësia e mostrës} = \frac{\frac{z^2 \times p(1-p)}{e^2}}{1 + \left(\frac{z^2 \times p(1-p)}{e^2 \times N}\right)}$$

Tabela 1. Shpjegimi i simboleve të formulës

| Simboli | Kuptimi                | Përshkrimi  | Vlera |
|---------|------------------------|---|-------|
| z       | Shkalla z              | Është numri i devijimeve standarde që një proporcion i caktuar është larg mesatares. Vlerat e shkallëve z mund të gjenden duke përdorur tabela të disponueshme (shih Tabela 2). | 1.96  |
| p       | Përqindja e popullsisë | Është një koncept që tregon se cila pjesë (ose përqindje) e një popullate të tërë ka një karakteristikë të caktuar. Duhet të përdoret vlera 50% nëse nuk jeni të sigurt.        | 0.5   |
| e       | Marzhi i gabimit       | Është një përqindje që tregon se sa saktë rezultatet e anketës pasqyrojnë mendimet e të gjithë popullatës.  | 0.05  |
| N       | Madhësia e popullatës  | Përfaqëson numrin e përgjithshëm të personave në grupin që studiohet.   | 4000  |

Tabela 2. Vlerat e shkallëve z

| Niveli i Besimit | Shkalla z |
|------------------|-----------|
| 0.70             | 1.04      |
| 0.75             | 1.15      |
| 0.80             | 1.28      |
| 0.85             | 1.44      |
| 0.92             | 1.75      |
| 0.95             | 1.96      |
| 0.96             | 2.05      |
| 0.98             | 2.33      |
| 0.99             | 2.58      |
| 0.999            | 3.29      |
| 0.9999           | 3.89      |
| 0.99999          | 4.42      |

$$\begin{aligned}
 \text{Madhësia e mostrës} &= \frac{\frac{z^2 \times p(1-p)}{e^2}}{1 + \left(\frac{z^2 \times p(1-p)}{e^2 \times N}\right)} = \frac{\frac{1.96^2 \times 0.5(1-0.5)}{0.05^2}}{1 + \left(\frac{1.96^2 \times 0.5(1-0.5)}{0.05^2 \times 4000}\right)} = \frac{\frac{3.84 \times 0.25}{0.0025}}{1 + \left(\frac{3.84 \times 0.25}{0.0025 \times 4000}\right)} \\
 &= \frac{0.96}{1 + \frac{0.96}{10}} = \frac{0.96}{\frac{10 + 0.96}{10}} = \frac{0.96}{\frac{10.96}{10}} = \frac{9.6}{10.96} = 0.8758758758758759 \approx 350
 \end{aligned}$$

**Madhësia e mostrës = 350 respondentë**

Madhësia e mostrës e përcaktuar përmes formulës statistikore ka rezultuar në 350 respondentë, që përfaqëson numrin minimal të nevojshëm për të siguruar besueshmëri dhe përfaqësueshmëri të të dhënave. Megjithatë, në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar gjithsej 365 të diplomuar, duke tejkaluar pragun minimal të kërkuar. Ky tejkalim kontribuon në rritjen e saktësisë së rezultateve dhe përmirëson bazën analitike të studimit, duke e bërë atë më të qëndrueshëm dhe më të besueshëm në nxjerrjen e përfundimeve.

# **REZULTATET DHE DISKUTIMI**


Ky seksioni përfshin paraqitjen dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura nga 365 të diplomuar të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë. Rezultatet janë organizuar në mënyrë tematike, duke filluar nga karakteristikat demografike dhe akademike të të anketuarve, e deri tek aspektet që lidhen me statusin e punësimit, kohën e integritit në tregun e punës, sektorin e angazhimit dhe përputhjen ndërmjet fushës së studimit dhe punës aktuale. Të dhënat janë prezantuar kryesisht në formë tabelare dhe grafike, si dhe janë shoqëruar me interpretime përkatëse, duke mundësuar një pasqyrë të qartë të shpërndarjes dhe tendencave kryesore.

Në pjesën e diskutimit, gjetjet janë analizuar në funksion të qëllimit të hulumtimit, duke u fokusuar në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në punësueshmërinë e të diplomuarve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar perceptimeve të të anketuarve mbi përgatitjen profesionale, rëndësinë e arsimit universitar, rolin e praktikave profesionale dhe aftësive të fituara gjatë studimeve, si dhe sfidave të hasura gjatë kërkimit të punës. Përmes këtij kombinimi të rezultateve dhe analizës interpretuese, seksioni ofron një kuptim të thelluar të situatës aktuale të të diplomuarve dhe nxjerr në pah implikimet kryesore për përmirësimin e lidhjes ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës.

Tabela 3. Gjinia e të anketuarve

| Gjinia        | Frekuenca  | Përqindja    |
|---------------|------------|--------------|
| F             | 242        | 66.3         |
| M             | 123        | 33.7         |
| <b>Totali</b> | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 1. Gjinia e të anketuarve




Rezultatet tregojnë se shumica e të anketuarve i përkasin gjinisë femërore, e cila përfaqëson 66.3% të mostrës, ndërsa gjinia mashkullore përbën 33.7%. Kjo shpërndarje

tregon një dominim të pjesëmarrjes së femrave në hulumtim, duke reflektuar një përfaqësim më të lartë të tyre krahasuar me meshkujt.

Tabela 4. Viti i diplomimit të të anketuarve

| Viti i diplomimit  | Frekuenca  | Përqindja    |
|--------------------|------------|--------------|
| 2000 - 2011        | 21         | 5.8          |
| 2012               | 2          | 0.5          |
| 2013               | 3          | 0.8          |
| 2014               | 7          | 1.9          |
| 2015               | 10         | 2.7          |
| 2016               | 21         | 5.8          |
| 2017               | 21         | 5.8          |
| 2018               | 27         | 7.4          |
| 2019               | 30         | 8.2          |
| 2020               | 32         | 8.8          |
| 2021               | 17         | 4.7          |
| 2022               | 23         | 6.3          |
| 2023               | 30         | 8.2          |
| 2024               | 42         | 11.5         |
| 2025               | 71         | 19.5         |
| 2026               | 6          | 1.6          |
| Mungojnë të dhënat | 2          | 0.5          |
| <b>Totali</b>      | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 2. Viti i diplomimit të të anketuarve




Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë të të diplomuarve e përbën viti 2025 me 19.5%, duke reflektuar një dominim të të diplomuarve më të fundit në mostër. Pas tij renditet viti 2024 me 11.5%, ndërsa viti 2020 përfaqëson 8.8%. Po ashtu, vitet 2019 dhe 2023 kanë nga 8.2% secili, duke qenë ndër përqindjet më të larta në shpërndarje.

Ndërkohë, vitet e tjera paraqiten me përqindje më të ulëta dhe më të shpërndara, duke përfshirë një pjesëmarrje më modeste nga gjeneratat më të hershme dhe disa vite me përfaqësim minimal. Në tërësi, struktura e të dhënave tregon një përqendrim më të madh të të diplomuarve në vitet e fundit, duke reflektuar një prirje të theksuar drejt përfshirjes së gjeneratave më të reja në hulumtim.

Tabela 5. Niveli i studimeve të përfunduara

| Niveli i studimeve | Frekuenca  | Përqindja    |
|--------------------|------------|--------------|
| Bachelor           | 175        | 47.9         |
| Master             | 190        | 52.1         |
| <b>Totali</b>      | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 3. Niveli i studimeve të përfunduara




Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarve kanë përfunduar studimet në nivelin Master, të cilët përbëjnë 52.1% të mostrës, ndërsa 47.9% kanë përfunduar studimet në nivelin Bachelor. Kjo shpërndarje tregon një dominim të lehtë të të diplomuarve në nivelin Master, duke reflektuar një përfaqësim relativisht të balancuar ndërmjet dy niveleve të studimit në kuadër të hulumtimit.

Tabela 6. Programi i studimeve / Departamenti

| Programi i studimeve / Departamenti             | Frekuenca  | Përqindja    |
|---|------------|--------------|
| Agromjedis dhe Agroekologji                     | 2          | 0.5          |
| Administrim Biznesi                             | 66         | 18.1         |
| Administrim Biznesi: Gjuhë boshnjake            | 5          | 1.4          |
| Edukim Artistik në Intepretim                   | 4          | 1.1          |
| E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane            | 2          | 0.5          |
| Edukim në Muzikë                                | 13         | 3.6          |
| Informatikë e Aplikuar në Biznes                | 8          | 2.2          |
| Informatika në Biznes                           | 14         | 3.8          |
| Administrativ Kushtetues                        | 6          | 1.6          |
| Juridiko-Penal                                  | 5          | 1.4          |
| Juridik i Përgjithshëm                          | 40         | 11.0         |
| Kontabilitet dhe Financa                        | 62         | 17.0         |
| Menaxhim Biznesi                                | 32         | 8.8          |
| Menaxhim Biznesi: Gjuhë boshnjake               | 8          | 2.2          |
| Menaxhim Biznesi: Banka dhe Financa             | 5          | 1.4          |
| Menaxhim Biznesi: Kontabilitet dhe Auditim      | 2          | 0.5          |
| Menaxhim i Burimeve Njerëzore                   | 34         | 9.3          |
| Menaxhim Mjedis                                 | 10         | 2.7          |
| Menaxhim në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis       | 16         | 4.4          |
| Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm              | 1          | 0.3          |
| Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit të Ushqimit | 8          | 2.2          |
| Teknologjia e Prodhimit Bimor                   | 8          | 2.2          |
| Teknologji Ushqimore                            | 14         | 3.8          |
| <b>Totali</b>                                   | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë të të diplomuarve e përbën programi Administrim Biznesi me 18.1%, i ndjekur nga Kontabilitet dhe Financa me 17.0%. Në vijim renditet Juridik i Përgjithshëm me 11.0%, Menaxhim i Burimeve Njerëzore me 9.3%, si dhe Menaxhim Biznesi me 8.8%, duke përbërë pesë programet me përfaqësimin më të lartë në mostër.

Grafiku 4. Programi i studimeve / Departamenti




Programet e tjera paraqiten me përqindje më të ulëta dhe më të shpërndara, duke përfshirë fusha si teknologjia ushqimore, informatika, turizmi, arsimi artistik dhe drejtimet agro-mjedisore. Në tërësi, shpërndarja tregon një dominim të programeve të orientuara drejt biznesit, ekonomisë dhe menaxhimit, ndërsa fushat e tjera kanë një përfaqësim më të kufizuar në kuadër të hulumtimit.

Tabela 7. Vendi aktual i banimit

| Vendi aktual i banimit | Frekuenca  | Përqindja     |
|------------------------|------------|---------------|
| Brenda vendit          | 322        | 88.22         |
| Jashtë vendit          | 43         | 11.78         |
| <b>Totali</b>          | <b>365</b> | <b>100.00</b> |

Grafiku 5. Vendi aktual i banimit




Rezultatet tregojnë se shumica dërrmuese e të anketuarve aktualisht jetojnë brenda vendit, duke përbërë 88.22% të mostrës, ndërsa 11.78% e tyre jetojnë jashtë vendit. Kjo shpërndarje tregon një përqendrim të lartë të të diplomuarve në vendin e origjinës, ndërkohë që një pjesë më e vogël ka emigruar ose është zhvendosur jashtë vendit.

Tabela 8. Vendbanimi jashtë Kosovës

| Vendbanimi jashtë Kosovës | Frekuenca | Përqindja    |
|---------------------------|-----------|--------------|
| Amerikë                   | 2         | 0.55         |
| Angli                     | 1         | 0.27         |
| Austri                    | 5         | 1.37         |
| Gjermani                  | 22        | 6.03         |
| Itali                     | 1         | 0.27         |
| Luksemburg                | 1         | 0.27         |
| Mal i Zi                  | 4         | 1.10         |
| Shqipëri                  | 2         | 0.55         |
| Sloveni                   | 1         | 0.27         |
| Suedi                     | 1         | 0.27         |
| Turqi                     | 1         | 0.27         |
| Zvicërr                   | 2         | 0.55         |
| <b>Totali</b>             | <b>43</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 6. Vendbanimi jashtë Kosovës




Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë të të diplomuarve që jetojnë jashtë Kosovës e përbën Gjermania me 6.03%, duke qenë destinacioni kryesor i tyre. Pas saj renditen Austria me 1.37% dhe Mali i Zi me 1.10%, ndërsa Amerika, Shqipëria dhe Zvicra përfaqësohen secila me nga 0.55%.

Ndërkohë, vendet e tjera si Anglia, Italia, Luksemburgu, Sllovenia, Suedia dhe Turqia paraqiten me përqindje më të ulëta dhe me përfaqësim minimal. Në përgjithësi, shpërndarja tregon një përqendrim më të madh të të diplomuarve në disa vende evropiane, ndërsa vendet e tjera kanë një prezencë më të kufizuar.

Tabela 9. Statusi aktual i punësimit

| Statusi aktual i punësimit     | Frekuenca  | Përqindja    |
|--------------------------------|------------|--------------|
| I papunë                       | 8          | 2.2          |
| I papunë dhe në kërkim pune    | 87         | 23.8         |
| I punësuar me kohë të pjesshme | 26         | 7.1          |
| I punësuar me kohë të plotë    | 215        | 58.9         |
| I vetëpunësuar                 | 29         | 7.9          |
| <b>Totali</b>                  | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 7. Statusi aktual i punësimit




Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë të të anketuarve e përbëjnë të punësuarit me kohë të plotë, me 58.9%, duke reflektuar një nivel relativisht të lartë të integritit në tregun e punës. Pas tyre renditen të papunët dhe në kërkim aktiv të punës me 23.8%, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve ende përballen me sfida në sigurimin e një vendi pune.

Ndërkohë, 7.9% e të anketuarve janë të vetëpunësuar, ndërsa 7.1% janë të punësuar me kohë të pjesshme, duke treguar forma alternative të angazhimit në tregun e punës. Një përqindje më e vogël, prej 2.2%, rezultojnë të jetë të papunë dhe jo në kërkim aktiv të punës. Në përgjithësi, struktura e të dhënave tregon dominimin e punësimit me kohë të plotë, por edhe praninë e një segmenti të konsiderueshëm që vazhdon të kërkojë punë.

Tabela 10. Raporti "të punësuar - të papunësuar"

| Raporti "të punësuar - të papunësuar" | Frekuenca  | Përqindja    |
|---------------------------------------|------------|--------------|
| Të punësuar                           | 270        | 74.0         |
| Të papunësuar                         | 95         | 26.0         |
| <b>Totali</b>                         | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 8. Raporti “të punësuar - të papunësuar”




Rezultatet tregojnë se shumica e të anketuarve janë të punësuar, duke përbërë 74.0% të mostrës, ndërsa 26.0% rezultojnë të jenë të papunësuar. Kjo shpërndarje reflekton një raport të favorshëm në drejtim të punësimit, duke treguar se një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve kanë arritur të integrohen në tregun e punës, megjithëse një segment i rëndësishëm vazhdon të mbetet jashtë tij.

Tabela 11. Sa kohë pas diplomimit e keni gjetur punën e parë?

| Sa kohë pas diplomimit e keni gjetur punën e parë? | Frekuenca  | Përqindja  |
|--|------------|------------|
| Brenda 1 viti                                      | 38         | 10.4       |
| Brenda 3 muajve                                    | 35         | 9.6        |
| Brenda 6 muajve                                    | 29         | 7.9        |
| Ende nuk kam punuar pas diplomimit                 | 65         | 17.8       |
| Isha i punësuar gjatë studimeve                    | 138        | 37.8       |
| Nuk kam kërkuar ende punë                          | 10         | 2.7        |
| Pas më shumë se 1 viti                             | 50         | 13.7       |
| <b>Totali</b>                                      | <b>365</b> | <b>100</b> |

Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e përbëjnë të anketuarit që kanë qenë të punësuar që gjatë studimeve, me 37.8%, duke reflektuar një përfshirje të hershme në tregun e punës. Pas tyre renditen ata që ende nuk kanë punuar pas diplomimit me 17.8%, ndërsa 13.7% kanë gjetur punën e parë pas më shumë se një viti.

Grafiku 9. Sa kohë pas diplomimit e keni gjetur punën e parë?




Gjithashtu, 10.4% e të diplomuarve kanë siguruar punë brenda një viti, 9.6% brenda tre muajve dhe 7.9% brenda gjashtë muajve, duke treguar se një pjesë e konsiderueshme arrin të integrohet relativisht shpejt në tregun e punës pas diplomimit. Një përqindje më e vogël, prej 2.7%, deklaroi se ende nuk ka kërkuar punë. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një kombinim të hyrjes së hershme në tregun e punës dhe periudhave të ndryshme të tranzicionit pas diplomimit.

Tabela 12. Sektori i punësimit të të anketuarve

| Sektori i punësimit të të anketuarve | Frekuenca  | Përqindja    |
|--------------------------------------|------------|--------------|
| Sektor privat                        | 147        | 40.3         |
| Sektor publik                        | 114        | 31.2         |
| OJQ                                  | 2          | 0.5          |
| Organizatë ndërkombëtare             | 2          | 0.5          |
| Të papunë                            | 95         | 26.0         |
| Mungojnë të dhënat                   | 5          | 1.4          |
| <b>Totali</b>                        | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 10. Sektori i punësimit të të anketuarve



Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë të punësimit e përbën sektori privat me 40.3%, duke reflektuar rolin dominues të këtij sektori në punësimin e të diplomuarve. Pas tij renditet sektori publik me 31.2%, i cili gjithashtu zë një peshë të konsiderueshme në tregun e punës.


Ndërkohë, një përqindje shumë e vogël e të anketuarve janë të angazhuar në organizata joqeveritare (0.5%) dhe organizata ndërkombëtare (0.5%), duke treguar një përfaqësim minimal të këtyre sektorëve në punësimin e të diplomuarve. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një përqendrim të theksuar të punësimit në sektorin privat dhe atë publik.

Tabela 13. Pozita ose titulli i vendit të punës

| Pozita ose titulli i vendit të punës | Frekuenca  | Përqindja    |
|--------------------------------------|------------|--------------|
| Administrator                        | 3          | 0.8          |
| Agjent                               | 4          | 1.1          |
| Analist Kreditor                     | 2          | 0.5          |
| Arkatar ose Sektorist                | 9          | 2.5          |
| Asistent                             | 14         | 3.8          |
| Avokat ose Jurist                    | 2          | 0.5          |
| Bashkëpunëtor i Jashtëm              | 1          | 0.3          |
| Ekonomist                            | 1          | 0.3          |
| Faturist                             | 1          | 0.3          |
| Financier                            | 2          | 0.5          |
| Gjyqtar                              | 1          | 0.3          |
| Hetues                               | 1          | 0.3          |
| Infermier                            | 3          | 0.8          |
| Inspektor                            | 2          | 0.5          |
| Pozitë udhëheqëse/menaxheriale       | 67         | 18.4         |
| Kalkulant                            | 2          | 0.5          |
| Këshilltar                           | 2          | 0.5          |
| Kontabilist                          | 14         | 3.8          |
| Kontrollor i Trafikut Ajror          | 1          | 0.3          |
| Koordinator                          | 2          | 0.5          |
| Mbikëqyrës                           | 2          | 0.5          |
| Zyrtar                               | 48         | 13.2         |
| Mësimdhënës                          | 16         | 4.4          |
| Praktikant                           | 10         | 2.7          |
| Profesor Universitar                 | 12         | 3.3          |
| Shitës                               | 5          | 1.4          |
| Zëvendës                             | 5          | 1.4          |
| Tjetër                               | 32         | 8.8          |
| Të papunë                            | 95         | 26.0         |
| Mungojnë të dhënat                   | 6          | 1.6          |
| <b>Totali</b>                        | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e përbëjnë pozitat udhëheqëse/menaxheriale me 18.4%, duke reflektuar një prani të konsiderueshme të të diplomuarve në role drejtuese. Pas tyre renditen pozitat zyrtare me 13.2%, ndërsa kategoria “Tjetër” përbën 8.8%, duke treguar një gamë të gjerë pozicionesh të ndryshme që nuk janë specifikuar më tej.

Grafiku 11. Pozita ose titulli i vendit të punës



Në vijim, mësimdhënësit përfaqësojnë 4.4%, ndërsa pozitat e asistentit dhe kontabilistit kanë nga 3.8% secila. Profesorët universitarë përbëjnë 3.3%, ndërsa praktikantët 2.7% dhe arkatarët ose sektoristët 2.5%.


Pozitat si shitës dhe zëvendës kanë nga 1.4% secila, ndërsa agjentët përfaqësojnë 1.1%. Administratorët dhe infermierët kanë nga 0.8% secila. Ndërkohë, një grup më i madh pozicionesh si analist kreditor, avokat ose jurist, financier, inspektor, kalkulant, këshilltar, koordinator dhe mbikëqyrës paraqiten me nga 0.5% secila. Pozita të tjera si bashkëpunëtor i jashtëm, ekonomist, faturist, gjyqtar, hetues dhe kontrollor i trafikut ajror kanë nga 0.3% secila.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një shpërndarje të larmishme të pozitive të punës, me dominim të roleve menaxheriale dhe administrative, ndërsa një numër i madh pozicionesh të tjera paraqiten me përfaqësim më të ulët dhe të ngjashëm ndërmjet tyre.

Tabela 14. Lloji i ndërmarrjes ku janë të punësuar të anketuarit

| Lloji i ndërmarrjes | Frekuenca  | Përqindja    |
|---------------------|------------|--------------|
| Prodhuese           | 18         | 4.9          |
| Shërbyese           | 187        | 51.2         |
| Tregtare            | 41         | 11.2         |
| Biznes Individual   | 10         | 2.7          |
| Të papunë           | 95         | 26.0         |
| Mungojnë të dhënat  | 14         | 3.8          |
| <b>Totali</b>       | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 12. Lloji i ndërmarrjes ku janë të punësuar të anketuarit




Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e zënë ndërmarrjet shërbyese me 51.2%, duke reflektuar dominimin e këtij sektori në punësimin e të diplomuarve. Pas tyre renditen ndërmarrjet tregtare me 11.2%, të cilat gjithashtu përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme.

Ndërkohë, ndërmarrjet prodhuese përbëjnë 4.9%, ndërsa bizneset individuale, ku nuk është specifikuar lloji i ndërmarrjes, përfaqësojnë 2.7%. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një përqendrim të theksuar të të diplomuarve në sektorin e shërbimeve, ndërsa sektorët e tjerë kanë një përfaqësim më të ulët.

Tabela 15. A është puna juaj aktuale në fushën për të cilën keni diplomuar?

| A është puna juaj aktuale në fushën për të cilën keni diplomuar? | Frekuenca  | Përqindja    |
|--|------------|--------------|
| Jo, në një fushë tjetër  | 61         | 16.7         |
| Pjesërisht   | 102        | 27.9         |
| Po, plotësisht   | 107        | 29.3         |
| Të papunë  | 95         | 26.0         |
| <b>Totali</b>  | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 13. A është puna juaj aktuale në fushën për të cilën keni diplomuar?



Rezultatet tregojnë se 29.3% e të anketuarve janë të punësuar plotësisht në fushën për të cilën kanë diplomuar, duke përfaqësuar përqindjen më të lartë në këtë kategori. Ndërkohë, 27.9% deklarojnë se puna e tyre lidhet pjesërisht me fushën e studimeve, çka tregon një nivel të moderuar të përputhshmërisë ndërmjet arsimit dhe angazhimit profesional.

Nga ana tjetër, 16.7% e të anketuarve janë të punësuar në një fushë krejtësisht tjetër nga ajo e studimeve, duke reflektuar një mospërputhje të plotë ndërmjet përgatitjes akademike dhe punës aktuale. Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë se, megjithëse një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve arrijnë të punojnë në fushën e tyre ose të lidhur me të, ekziston ende një nivel i dukshëm i devijimit drejt fushave të tjera të punës.

Tabela 16. Fusha e punësimit kundrejt fushës së studimit të të anketuarve që janë punësuar në fushë tjetër

|                      | Fusha e studimit                               |    |                            |    |     |    |    |    |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|----------------------|--|----|----------------------------|----|-----|----|----|----|----|-------------------------|------|----|------|------|-----|----|---|
|                      | AA   | AB | AB -<br>Gjuhë<br>boshnjake | EM | IAB | IB | JP | KF | MB | MB - Gjuhë<br>boshnjake | MBNJ | MM | MTHM | SQPU | TPB | TU |   |
| Fusha e punësimit    | Administratë                                   |    |                            |    |     |    |    |    |    |                         |      | ✓  |      | ✓    |     | ✓  |   |
|                      | Arsim  |    |                            |    |     |    |    |    | ✓  |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Aviacion                                       |    |                            |    |     |    | ✓  |    |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Banka dhe Financa                              |    |                            |    |     |    | ✓  |    |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Blegtori dhe<br>grumbullim qumështi            |    |                            |    |     | ✓  |    |    |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Qendër bukurie                                 |    |                            |    |     |    |    | ✓  |    | ✓                       |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Dekore për Dasma<br>dhe Evente                 |    |                            |    |     |    |    |    |    |                         |      |    | ✓    |      |     |    |   |
|                      | Drejtor teknik i<br>mirëmbajtjes<br>(makineri) |    |                            |    |     |    |    | ✓  |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Ekonomi  |    |                            |    |     |    |    | ✓  |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Elektro  |    | ✓                          |    |     |    |    |    |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Ëmbëltore                                      |    |                            |    |     |    |    | ✓  |    |                         | ✓    |    |      |      |     |    |   |
|                      | Financa  |    |                            |    |     |    |    | ✓  |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Gastronomi                                     |    |                            |    |     |    |    |    |    |                         |      |    |      |      |     | ✓  |   |
|                      | Gazetari                                       |    |                            |    |     |    |    |    |    | ✓                       |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Hoteleri                                       |    |                            |    |     |    |    |    | ✓  |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Instalim i paneleve<br>solare                  |    |                            |    |     |    |    |    |    |                         |      |    |      |      |     |    | ✓ |
|                      | IT   |    |                            |    |     |    |    |    |    |                         |      |    |      | ✓    |     |    |   |
|                      | Librari  |    |                            |    |     |    |    |    |    |                         |      | ✓  |      |      |     |    |   |
|                      | Logjistikë                                     |    |                            |    |     |    |    |    | ✓  |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Menaxhim mjedisi                               |    |                            |    |     |    |    |    |    |                         |      | ✓  |      |      |     |    |   |
|                      | Ndërtim  |    | ✓                          |    |     |    |    | ✓  |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Përmbaram                                      |    |                            |    |     |    |    |    |    |                         |      |    |      |      |     | ✓  |   |
|                      | Prodhim  |    | ✓                          |    |     |    |    | ✓  |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Punë online                                    |    |                            |    |     |    |    | ✓  |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
|                      | Shëndetësi                                     |    | ✓                          |    |     |    |    | ✓  |    |                         |      |    |      |      |     | ✓  |   |
|                      | Shërbim për klient                             |    |                            |    |     |    |    | ✓  | ✓  |                         |      |    |      |      |     |    |   |
| Shitje               | ✓  |    |                            | ✓  | ✓   |    | ✓  | ✓  |    |                         |      |    |      |      | ✓   | ✓  |   |
| Stomatologji         |  |    |                            |    |     |    |    | ✓  |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
| Turizëm              |  |    | ✓                          |    |     |    |    |    |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |
| Zhvillues softuerësh |  |    |                            |    |     |    |    | ✓  |    |                         |      |    |      |      |     |    |   |

Nga analiza e tabelës vërehen disa raste përfaqësuese që ilustrojnë mospërputhjen ndërmjet fushës së studimit dhe asaj të punësimit:

Për shembull, ka të diplomuar nga programi Kontabilitet dhe Financa (KF) që janë të angazhuar edhe në fusha si dekore për evente, logjistikë, shërbim për klient apo shitje. Ka të diplomuar nga programi Administrim Biznesi (AB) të punësuar në fusha të ndryshme si elektro, ndërtimi, prodhimi apo shëndetësia, çka tregon një zhvendosje të


konsiderueshme nga profili i tyre fillestar akademik. Një tjetër shembull është ai i të diplomuarve nga programi Juridik i Përgjithshëm (JP), të cilët në fusha janë të përfshirë si aviacioni, bankat dhe financat, prodhimi, shitja etj. Po ashtu, të diplomuarit nga programi Menaxhim Biznesi (MB) janë të shpërndarë në fushat si arsimi, hoteleia apo stomatologjia. Një rast tjetër paraqitet tek të diplomuarit nga fusha të teknologjisë ushqimore dhe teknologjisë së prodhimit bimor (TU, TPB), të cilët janë të angazhuar me punë në fushat si administrata, gastronomia, instalimi i paneleve solare, përmbarimi, puna online apo shërbimi për klient, duke reflektuar zhvendosje drejt sektorëve më teknikë dhe aplikativë.

Në përgjithësi, këta shembuj tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve janë të angazhuar në fusha të ndryshme nga ato të studimit, duke reflektuar një treg pune dinamik ku fleksibiliteti dhe aftësitë e transferueshme luajnë rol të rëndësishëm.

Tabela 17. Sa i rëndësishëm ishte niveli i arsimit tuaj universitar për të siguruar punën aktuale?

| Sa i rëndësishëm ishte niveli i arsimit tuaj universitar për të siguruar punën aktuale? | Frekuenca  | Përqindja    |
|---|------------|--------------|
| Aspak i rëndësishëm   | 13         | 3.6          |
| Mjaft i rëndësishëm   | 73         | 20.0         |
| Pak i rëndësishëm   | 44         | 12.1         |
| Shumë i rëndësishëm   | 140        | 38.4         |
| Të papunë   | 95         | 26.0         |
| <b>Totali</b>   | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 14. Sa i rëndësishëm ishte niveli i arsimit tuaj universitar për të siguruar punën aktuale?




Rezultatet tregojnë se 38.4% e të anketuarve e vlerësojnë nivelin e arsimit universitar si shumë të rëndësishëm për sigurimin e punës aktuale, duke përbërë përqindjen më të lartë. Pas kësaj, 20.0% e konsiderojnë atë mjaft të rëndësishëm, çka tregon një vlerësim pozitiv të rolit të arsimit në punësim. Ndërkohë, 12.1% e të anketuarve e vlerësojnë arsimin si pak të rëndësishëm, ndërsa 3.6% deklarojnë se ai nuk ka qenë aspak i rëndësishëm. Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë se arsimi universitar perceptohet kryesisht si faktor me ndikim të konsiderueshëm në sigurimin e punës, megjithëse ekziston edhe një segment që e vlerëson këtë ndikim më të kufizuar.

*Tabela 18. Sa e vlerësoni përgatitjen profesionale që keni fituar gjatë studimeve?*

| Sa e vlerësoni përgatitjen profesionale që keni fituar gjatë studimeve? | Frekuenc<br>a | Përqindj<br>a |
|---|---------------|---------------|
| Mesatare  | 50            | 13.7          |
| Shumë të mirë   | 176           | 48.2          |
| Të dobët  | 2             | 0.5           |
| Të mirë   | 137           | 37.5          |
| <b>Totali</b>   | <b>365</b>    | <b>100</b>    |

*Grafiku 15. Sa e vlerësoni përgatitjen profesionale që keni fituar gjatë studimeve?*



Rezultatet tregojnë se 48.2% e të anketuarve e vlerësojnë përgatitjen profesionale të fituar gjatë studimeve si shumë të mirë, duke përbërë përqindjen më të lartë. Po ashtu, 37.5% e vlerësojnë atë si të mirë, çka tregon një perceptim përgjithësisht pozitiv ndaj cilësisë së përgatitjes profesionale. Ndërkohë, 13.7% e të anketuarve e konsiderojnë përgatitjen si mesatare, ndërsa vetëm 0.5% e vlerësojnë atë si të dobët. Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë se shumica e të diplomuarve kanë një vlerësim të lartë për përgatitjen profesionale të fituar gjatë studimeve, ndërsa një pjesë shumë e vogël shpreh pakënaqësi në këtë drejtim.


Tabela 19. Në cilat fusha mendoni se universiteti mund të përmirësohet për të rritur punësueshmërinë e studentëve?

| Në cilat fusha mendoni se universiteti mund të përmirësohet për të rritur punësueshmërinë e studentëve?                              | Frekuenca  | Përqindja    |
|--|------------|--------------|
| Aftësitë digjitale   | 5          | 1.4          |
| Aftësitë digjitale, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale  | 1          | 0.3          |
| Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale  | 12         | 3.3          |
| Bashkëpunimi me bizneset   | 20         | 5.5          |
| Bashkëpunimi me bizneset, Aftësitë digjitale   | 1          | 0.3          |
| Bashkëpunimi me bizneset, Aftësitë digjitale, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale  | 1          | 0.3          |
| Bashkëpunimi me bizneset, Përmbajtja e kurrikulës  | 1          | 0.3          |
| Përmbajtja e kurrikulës  | 2          | 0.5          |
| Përmbajtja e kurrikulës, Aftësitë digjitale  | 2          | 0.5          |
| Praktikat profesionale   | 107        | 29.3         |
| Praktikat profesionale, Aftësitë digjitale   | 10         | 2.7          |
| Praktikat profesionale, Aftësitë digjitale, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale  | 6          | 1.6          |
| Praktikat profesionale, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale  | 8          | 2.2          |
| Praktikat profesionale, Bashkëpunimi me bizneset   | 52         | 14.2         |
| Praktikat profesionale, Bashkëpunimi me bizneset, Aftësitë digjitale   | 19         | 5.2          |
| Praktikat profesionale, Bashkëpunimi me bizneset, Aftësitë digjitale, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale                          | 30         | 8.2          |
| Praktikat profesionale, Bashkëpunimi me bizneset, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale  | 22         | 6.0          |
| Praktikat profesionale, Bashkëpunimi me bizneset, Përmbajtja e kurrikulës  | 5          | 1.4          |
| Praktikat profesionale, Bashkëpunimi me bizneset, Përmbajtja e kurrikulës, Aftësitë digjitale  | 6          | 1.6          |
| Praktikat profesionale, Bashkëpunimi me bizneset, Përmbajtja e kurrikulës, Aftësitë digjitale, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale | 28         | 7.7          |
| Praktikat profesionale, Bashkëpunimi me bizneset, Përmbajtja e kurrikulës, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale                     | 3          | 0.8          |
| Praktikat profesionale, Përmbajtja e kurrikulës  | 4          | 1.1          |
| Praktikat profesionale, Përmbajtja e kurrikulës, Aftësitë digjitale  | 3          | 0.8          |
| Praktikat profesionale, Përmbajtja e kurrikulës, Aftësitë digjitale, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale                           | 2          | 0.5          |
| Praktikat profesionale, Përmbajtja e kurrikulës, Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale   | 4          | 1.1          |
| Tjetër   | 11         | 3.0          |
| <b>Totali</b>  | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e përbën përmirësimi i praktikave profesionale me 29.3%, duke reflektuar nevojën më të theksuar për rritjen e komponentit praktik gjatë studimeve. Pas kësaj, kombinimi i praktikave profesionale me bashkëpunimin me bizneset përfaqëson 14.2%, duke nënvizuar rëndësinë e lidhjes ndërmjet universitetit dhe tregut të punës.

Gjithashtu, 8.2% e të anketuarve theksojnë nevojën për përmirësim të integruar në disa fusha njëkohësisht, përfshirë praktikën profesionale, bashkëpunimin me bizneset, si dhe aftësitë digjitale dhe aftësitë komunikuese dhe menaxheriale. Një tjetër përqindje e konsiderueshme prej 7.7% përfshin të njëjtat fusha duke shtuar edhe përmbajtjen e kurrikulës, ndërsa 6.0% theksojnë kombinimin e praktikave profesionale, bashkëpunimit me bizneset dhe aftësive komunikuese dhe menaxheriale. Po ashtu, 5.5% e të anketuarve veçojnë vetëm bashkëpunimin me bizneset si fushë kryesore për përmirësim.

*Grafiku 16. Në cilat fusha mendoni se universiteti mund të përmirësohet për të rritur punësueshmërinë e studentëve?*




Ndërkohë, kategoritë e tjera paraqiten me përqindje më të ulëta dhe shpesh në kombinime të ndryshme ndërmjet dy e më shumë nga fushat e dhëna. Në përgjithësi, këto rezultate tregojnë se theksi kryesor vihet tek forcimi i komponentit praktik dhe lidhja më e ngushtë me tregun e punës, ndërsa fushat e tjera konsiderohen si mbështetëse në rritjen e punësueshmërisë së studentëve.

Tabela 20. A keni marrë pjesë në ndonjë praktikë profesionale gjatë studimeve?

| A keni marrë pjesë në ndonjë praktikë profesionale gjatë studimeve? | Frekuenc<br>a | Përqindj<br>a |
|---|---------------|---------------|
| Jo  | 160           | 43.8          |
| Po  | 205           | 56.2          |
| <b>Totali</b>   | <b>365</b>    | <b>100</b>    |

Grafiku 17. A keni marrë pjesë në ndonjë praktikë profesionale gjatë studimeve?




Rezultatet tregojnë se 56.2% e të anketuarve kanë marrë pjesë në praktikë profesionale gjatë studimeve, duke përbërë përqindjen më të lartë. Ndërkohë, 43.8% deklarojnë se nuk kanë pasur përvojë të tillë gjatë periudhës së studimeve. Kjo shpërndarje tregon se, megjithëse shumica e studentëve kanë qenë të përfshirë në praktika profesionale, një pjesë e konsiderueshme ende mbetet pa këtë përvojë, duke sugjeruar hapësirë për përmirësim në këtë aspekt.

Tabela 21. Nëse po, sa e dobishme ishte për përgatitjen tuaj profesionale?

| Nëse po, sa e dobishme ishte për përgatitjen tuaj profesionale? | Frekuenca  | Përqindja  |
|---|------------|------------|
| Jo e dobishme   | 10         | 2.7        |
| Pjesërisht e dobishme   | 57         | 15.6       |
| Shumë e dobishme  | 138        | 37.8       |
| Nuk ka kryer praktikë profesionale                              | 160        | 43.8       |
| <b>Totali</b>   | <b>365</b> | <b>100</b> |

Grafiku 18. Nëse po, sa e dobishme ishte për përgatitjen tuaj profesionale?




Rezultatet tregojnë se 37.8% e të anketuarve e vlerësojnë praktikën profesionale si shumë të dobishme për përgatitjen e tyre profesionale, duke përbërë përqindjen më të lartë. Ndërkohë, 15.6% e konsiderojnë atë pjesërisht të dobishme, çka tregon një vlerësim mesatar të përfitimeve nga praktika. Nga ana tjetër, vetëm 2.7% e të anketuarve e vlerësojnë praktikën si jo të dobishme. Në përgjithësi, këto rezultate sugjerojnë se praktikatat profesionale perceptohen kryesisht si një komponent me vlerë të lartë në zhvillimin e aftësive dhe përgatitjen për tregun e punës.

Tabela 22. A do ta rekomandonit programin tuaj të studimit tek të tjerët?

| A do ta rekomandonit programin tuaj të studimit tek të tjerët? | Frekuenca  | Përqindja  |
|--|------------|------------|
| Jo   | 42         | 11.5       |
| Po   | 323        | 88.5       |
| <b>Totali</b>  | <b>365</b> | <b>100</b> |

Grafiku 19. A do ta rekomandonit programin tuaj të studimit tek të tjerët?



Rezultatet tregojnë se shumica dërrmuese e të anketuarve, përkatësisht 88.5%, do ta rekomandonin programin e tyre të studimit tek të tjerët, duke reflektuar një nivel të lartë kënaqësie me përvojën akademike. Ndërkohë, 11.5% e të anketuarve nuk do ta rekomandonin programin, çka tregon se ekziston një pjesë më e vogël me qëndrime më kritike. Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë një perceptim shumë pozitiv ndaj programeve të studimit.


Tabela 23. Cilat aftësi të fituara në UHZ i përdorni më së shumti në punën tuaj?

| Cilat aftësi të fituara në UHZ i përdorni më së shumti në punën tuaj?             | Frekuenca | Përqindja |
|---|-----------|-----------|
| Aftësitë praktike profesionale  | 23        | 6.3       |
| Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit  | 20        | 5.5       |
| Aftësitë kërkimore  | 4         | 1.1       |
| Aftësitë e punës në grup  | 13        | 3.6       |
| Shkathtësitë e përdorimit të teknologjisë   | 3         | 0.8       |
| Aftësitë kritike dhe analitike  | 2         | 0.5       |
| Planifikimi dhe menaxhimi i kohës   | 9         | 2.5       |
| Të gjitha aftësitë e dhëna  | 28        | 7.7       |
| Aftësitë praktike profesionale, Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit            | 2         | 0.5       |
| Aftësitë praktike profesionale, Aftësitë e punës në grup                          | 1         | 0.3       |
| Aftësitë praktike profesionale, Aftësitë kritike dhe analitike                    | 1         | 0.3       |
| Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit, Aftësitë e punës në grup                  | 6         | 1.6       |
| Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit, Aftësitë kërkimore                        | 2         | 0.5       |
| Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit, Aftësitë kritike dhe analitike            | 1         | 0.3       |
| Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit, Shkathtësitë e përdorimit të teknologjisë | 1         | 0.3       |
| Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit, Planifikimi dhe menaxhimi i kohës         | 5         | 1.4       |
| Aftësitë kërkimore, Aftësitë e punës në grup                                      | 1         | 0.3       |
| Aftësitë kërkimore, Aftësitë kritike dhe analitike                                | 4         | 1.1       |
| Aftësitë kërkimore, Planifikimi dhe menaxhimi i kohës                             | 1         | 0.3       |
| Aftësitë kritike dhe analitike, Planifikimi dhe menaxhimi i kohës                 | 2         | 0.5       |
| Aftësitë e punës në grup, Aftësitë kritike dhe analitike                          | 2         | 0.5       |
| Aftësitë e punës në grup, Planifikimi dhe menaxhimi i kohës                       | 3         | 0.8       |
| Aftësitë e punës në grup, Shkathtësitë e përdorimit të teknologjisë               | 1         | 0.3       |
| Aftësitë praktike profesionale, Aftësitë kritike dhe analitike                    | 1         | 0.3       |
| Aftësitë praktike profesionale, Shkathtësitë e përdorimit të teknologjisë         | 1         | 0.3       |
| Më shumë se dy nga aftësitë e dhëna   | 124       | 34.0      |
| Të papunë   | 95        | 26.0      |
| Mungojnë të dhënat  | 9         | 2.5       |
| Totali  | 365       | 100.0     |

Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e përbëjnë të anketuarit që deklarojnë se përdorin më shumë se dy nga aftësitë e fituara gjatë studimeve, me 34.0%, duke reflektuar një aplikim të gjerë dhe të kombinuar të kompetencave në vendin e punës. Pas kësaj, 7.7%

e të anketuarve theksojnë se përdorin të gjitha aftësitë e dhëna, çka tregon një nivel të lartë të shfrytëzimit të njohurive të përfituara.

Grafiku 20. Cilat aftësi të fituara në UHZ i përdorni më së shumti në punën tuaj?




Ndër aftësitë specifike, 6.3% e të anketuarve veçojnë aftësitë praktike profesionale, ndërsa 5.5% theksojnë aftësitë e komunikimit dhe prezantimit. Po ashtu, 3.6% vlerësojnë si më të përdorshme aftësitë e punës në grup, ndërsa 2.5% përmendin planifikimin dhe menaxhimin e kohës. Ndërkohë, kombinimet e ndryshme të aftësive dhe kategoritë e tjera paraqiten me përqindje më të ulëta dhe të shpërndara, duke përfshirë aftësi kërkimore, analitike dhe teknologjike, si dhe ndërthurje të tyre. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se të diplomuarit përdorin kryesisht një kombinim të aftësive në praktikë.

Tabela 24. Niveli i të ardhurave mujore

| Niveli i të ardhurave mujore | Frekuenca  | Përqindja    |
|------------------------------|------------|--------------|
| deri 300€                    | 14         | 3.8          |
| 300 - 500€                   | 46         | 12.6         |
| 500 - 800€                   | 82         | 22.5         |
| mbi 800€                     | 124        | 34.0         |
| Të papunë                    | 95         | 26.0         |
| Mungojnë të dhënat           | 4          | 1.1          |
| <b>Totali</b>                | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 21. Niveli i të ardhurave mujore




Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e përbëjnë të anketuarit me të ardhura mujore mbi 800€, me 34.0%, duke reflektuar një nivel relativisht të favorshëm të të ardhurave për një pjesë të konsiderueshme të të diplomuarve. Pas kësaj, 22.5% e të anketuarve kanë të ardhura në intervalin 500 - 800€, ndërsa 12.6% përfshihen në kategorinë 300 - 500€. Ndërkohë, vetëm 3.8% e të anketuarve deklarojnë të ardhura deri

në 300€, duke përfaqësuar përqindjen më të ulët. Në përgjithësi, shpërndarja tregon një përqendrim më të madh të të ardhurave në nivelet mesatare dhe më të larta.

Tabela 25. A jeni ngritur në detyrë pas punësimit të parë?

| A jeni ngritur në detyrë pas punësimit të parë? | Frekuenca  | Përqindja  |
|---|------------|------------|
| Jo  | 112        | 30.7       |
| Po  | 162        | 44.4       |
| Nuk ka pasur akoma marrëdhënie pune             | 91         | 24.9       |
| <b>Totali</b>                                   | <b>365</b> | <b>100</b> |

Grafiku 22. A jeni ngritur në detyrë pas punësimit të parë?




Rezultatet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve kanë arritur progres në karrierën e tyre pas punësimit të parë, ku 44.4% deklarojnë se janë ngritur në detyrë. Kjo sugjeron një nivel të mirë të zhvillimit profesional dhe mundësi avancimi për një segment të rëndësishëm të të punësuarve. Nga ana tjetër, 30.7% e të anketuarve deklarojnë se nuk kanë përjetuar ngritje në detyrë, çka mund të lidhet me faktorë të ndryshëm si kohëzgjatja e shkurtër në tregun e punës, mungesa e mundësive për avancim apo karakteristikat e sektorit të punësimit.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë një tendencë pozitive drejt zhvillimit në karrierë për të diplomuarit, duke reflektuar potencial për rritje profesionale, por njëkohësisht edhe hapësirë për përmirësim në krijimin e mundësive më të gjera për avancim në punë.

Tabela 26. Niveli i qëndrueshmërisë së marrëdhënies së punës

| Niveli i qëndrueshmërisë së marrëdhënies së punës | Frekuenca  | Përqindja  |
|---|------------|------------|
| Nuk jam i/e sigurt                                | 7          | 1.9        |
| E paqëndrueshme                                   | 1          | 0.3        |
| Pak e qëndrueshme                                 | 2          | 0.5        |
| Mesatarisht e qëndrueshme                         | 29         | 7.9        |
| Mjaft e qëndrueshme                               | 89         | 24.4       |
| Shumë e qëndrueshme                               | 142        | 38.9       |
| Të papunë   | 95         | 26         |
| <b>Totali</b>                                     | <b>365</b> | <b>100</b> |

Grafiku 23. Niveli i qëndrueshmërisë së marrëdhënies së punës




Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e përbëjnë të anketuarit që e vlerësojnë marrëdhënien e tyre të punës si shumë të qëndrueshme, me 38.9%, duke reflektuar një nivel të lartë sigurie në punësim. Pas kësaj, 24.4% e konsiderojnë atë mjaft të qëndrueshme, ndërsa 7.9% e vlerësojnë si mesatarisht të qëndrueshme.

Ndërkohë, një përqindje shumë e vogël e të anketuarve e percepton marrëdhënien e punës si pak të qëndrueshme (0.5%) ose të paqëndrueshme (0.3%), ndërsa 1.9% deklarojnë se nuk janë të sigurt për qëndrueshmërinë e saj. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një nivel të lartë të qëndrueshmërisë së marrëdhënies së punës tek shumica e të diplomuarve.

Tabela 27. A keni ndjekur ndonjë trajnim / kurs pas diplomimit?

| A keni ndjekur ndonjë trajnim / kurs pas diplomimit? | Frekuenca  | Përqindja    |
|--|------------|--------------|
| Jo   | 182        | 49.9         |
| Po   | 183        | 50.1         |
| <b>Totali</b>  | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Grafiku 24. A keni ndjekur ndonjë trajnim / kurs pas diplomimit?




Rezultatet tregojnë një shpërndarje pothuajse të barabartë ndërmjet të anketuarve që kanë ndjekur trajnime apo kurse pas diplomimit dhe atyre që nuk kanë ndjekur. Konkretisht, 50.1% e të anketuarve deklarojnë se kanë marrë pjesë në trajnime pas diplomimit, ndërsa 49.9% nuk kanë ndjekur aktivitete të tilla. Kjo shpërndarje sugjeron se angazhimi në trajnime pas diplomimit nuk është i njëtrajtshëm, duke reflektuar një balancë ndërmjet atyre që vazhdojnë zhvillimin profesional dhe atyre që nuk janë përfshirë në këto aktivitete.

Sa i përket fushave të trajnimeve / kurseve të ndjekura, vërehet një diversitet i madh, ku dominojnë trajnimet në fusha si kontabiliteti dhe financat, teknologjia informative, menaxhimi dhe marketingu. Gjithashtu, në mënyrë të theksuar paraqiten edhe trajnimet në gjuhë të huaja (veçanërisht gjuha angleze dhe gjermane), si dhe praktikat profesionale në fusha si drejtësia dhe financat. Përveç këtyre, një numër i të diplomuarve kanë ndjekur trajnime në fusha të tjera si arsimit, siguria kibernetike, ndërmarrësia dhe zhvillimi profesional. Kjo tregon se të diplomuarit synojnë të rrisin kompetencat e tyre në drejtime të ndryshme, duke iu përshtatur kërkesave të tregut të punës.

Tabela 28. A planifikoni të vazhdoni studimet e mëtejshme (Master / PhD)?

| A planifikoni të vazhdoni studimet e mëtejshme (Master / PhD)? | Frekuenca  | Përqindja  |
|--|------------|------------|
| I kam vazhduar studimet  | 122        | 33.5       |
| Jo   | 74         | 20.3       |
| Ndoshta në të ardhmen  | 102        | 27.9       |
| Po   | 67         | 18.4       |
| <b>Totali</b>  | <b>365</b> | <b>100</b> |

Grafiku 25. A planifikoni të vazhdoni studimet e mëtejshme (Master / PhD)?



Rezultatet tregojnë se 33.5% e të anketuarve kanë vazhduar tashmë studimet e mëtejshme, duke përbërë përqindjen më të lartë. Pas kësaj, 27.9% deklarojnë se ndoshta do të vazhdojnë studimet në të ardhmen, çka tregon një interes potencial për avancim akademik. Ndërkohë, 20.3% e të anketuarve shprehen se nuk planifikojnë të vazhdojnë studimet, ndërsa 18.4% deklarojnë se kanë në plan të vazhdojnë studimet në të ardhmen. Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë një orientim të konsiderueshëm drejt vazhdimit të edukimit, qoftë aktualisht apo si synim i ardhshëm.


Tabela 29. Cilat aftësi mendoni se janë më të kërkuara nga punëdhënësit?

| Cilat aftësi mendoni se janë më të kërkuara nga punëdhënësit? | Frekuenca  | Përqindja    |
|---|------------|--------------|
| aftësi analitike  | 13         | 3.6          |
| aftësi analitike, komunikim                                   | 18         | 4.9          |
| aftësi analitike, komunikim, menaxhim projektsh               | 37         | 10.1         |
| aftësi analitike, komunikim, teknologji                       | 65         | 17.8         |
| aftësi analitike, komunikim, teknologji, menaxhim projektsh   | 42         | 11.5         |
| aftësi analitike, menaxhim projektsh                          | 5          | 1.4          |
| aftësi analitike, teknologji                                  | 7          | 1.9          |
| aftësi analitike, teknologji, menaxhim projektsh              | 29         | 7.9          |
| komunikim   | 26         | 7.1          |
| komunikim, menaxhim projektsh                                 | 7          | 1.9          |
| komunikim, teknologji   | 19         | 5.2          |
| komunikim, teknologji, menaxhim projektsh                     | 52         | 14.2         |
| menaxhim projektsh  | 12         | 3.3          |
| teknologji  | 9          | 2.5          |
| teknologji, menaxhim projektsh                                | 9          | 2.5          |
| Tjetër  | 15         | 4.1          |
| <b>Totali</b>   | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e përbën kombinimi i aftësive analitike, komunikimit dhe teknologjisë me 17.8%, duke reflektuar kërkesën e lartë të tregut për kompetenca të ndërthurura. Pas kësaj, 14.2% e të anketuarve theksojnë kombinimin e komunikimit, teknologjisë dhe menaxhimit të projekteve, ndërsa 11.5% përmendin një kombinim edhe më të gjerë që përfshin aftësitë analitike, komunikimin, teknologjinë dhe menaxhimin e projekteve. Gjithashtu, 10.1% e të anketuarve veçojnë kombinimin e aftësive analitike, komunikimit dhe menaxhimit të projekteve, ndërsa 7.9% theksojnë aftësitë analitike të kombinuara me teknologjinë dhe menaxhimin e projekteve. Po ashtu, 7.1% konsiderojnë komunikimin si aftësi të vetme kryesore të kërkuar nga punëdhënësit.

Ndërkohë, kategoritë e tjera paraqiten me përqindje më të ulëta dhe përfshijnë kombinime të ndryshme të aftësive analitike, teknologjike dhe menaxheriale, si dhe aftësi të veçanta individuale. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se punëdhënësit kërkojnë kryesisht një kombinim të aftësive, veçanërisht ato që lidhen me analizën, komunikimin dhe teknologjinë.

Grafiku 26. Cilat aftësi mendoni se janë më të kërkuara nga punëdhënësit?



Nga përgjigjet e përfshira në kategorinë “Tjetër” vërehet një theks i veçantë në aftësi të ndryshme praktike dhe profesionale që lidhen drejtpërdrejt me kërkesat e tregut të punës. Të anketuarit theksojnë rëndësinë e aftësive organizative dhe menaxheriale, përfshirë planifikimin, operimin, logjistikën dhe mbikëqyrjen, si komponentë kyç për performancë efektive në vendin e punës.

Po ashtu, vihet në pah rëndësia e mendimit kritik dhe aftësisë për zgjidhjen e problemeve, si dhe trajtimi i çështjeve komplekse në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme. Një rol të rëndësishëm zënë edhe aftësitë profesionale të fituara përmes përvojës së punës,

certifikimeve individuale dhe angazhimit në kërkim shkencor, të cilat kontribuojnë në rritjen e kompetencave dhe konkurrueshmërisë në tregun e punës.

Gjithashtu, përmenden aftësi të tilla si përshtatshmëria në menaxhim, menaxhimi i stresit, ruajtja e konfidencialitetit dhe shërbimi ndaj konsumatorëve, të cilat reflektojnë kërkesën për profesionalizëm dhe etikë në mjedisin e punës. Në përgjithësi, këto përgjigje tregojnë një gamë të gjerë aftësish të avancuara dhe ndërdisiplinore, të cilat plotësojnë kategoritë standarde të paraqitura në pyetësor.

*Tabela 30. Sfidat kryesore për t'u punësuar*

| <b>Cilat janë sfidat kryesore që keni hasur për t'u punësuar?</b>  | <b>Frekuenc<br/>a</b> | <b>Përqindj<br/>a</b> |
|--|-----------------------|-----------------------|
| Mungesa e përvojës praktike gjatë studimeve  | 42                    | 11.5                  |
| Mungesa e vendeve të punës në fushën time  | 23                    | 6.3                   |
| Kërkesat e larta të punëdhënësve për përvojë pune  | 21                    | 5.8                   |
| Konkurrenca e lartë në tregun e punës  | 25                    | 6.8                   |
| Përputhje e ulët midis studimeve dhe kërkesave të tregut   | 2                     | 0.5                   |
| Mungesa e njohjeve / rrjetit profesional   | 2                     | 0.5                   |
| Mungesa e aftësive praktike apo digjitale të kërkuara nga tregu  | 2                     | 0.5                   |
| Paga të ulëta apo kushte jo të favorshme pune  | 18                    | 4.9                   |
| Të gjitha sfidat e dhëna   | 6                     | 1.6                   |
| Mungesa e përvojës praktike gjatë studimeve, Konkurrenca e lartë në tregun e punës                           | 5                     | 1.4                   |
| Mungesa e përvojës praktike gjatë studimeve, Mungesa e vendeve të punës në fushën time                       | 8                     | 2.2                   |
| Mungesa e përvojës praktike gjatë studimeve, Kërkesat e larta të punëdhënësve për përvojë pune               | 14                    | 3.8                   |
| Mungesa e përvojës praktike gjatë studimeve, Paga të ulëta apo kushte jo të favorshme pune                   | 5                     | 1.4                   |
| Mungesa e përvojës praktike gjatë studimeve, Përputhje e ulët midis studimeve dhe kërkesave të tregut        | 1                     | 0.3                   |
| Mungesa e vendeve të punës në fushën time, Kërkesat e larta të punëdhënësve për përvojë pune                 | 5                     | 1.4                   |
| Mungesa e vendeve të punës në fushën time, Konkurrenca e lartë në tregun e punës                             | 6                     | 1.6                   |
| Mungesa e vendeve të punës në fushën time, Mungesa e aftësive praktike apo digjitale të kërkuara nga tregu   | 1                     | 0.3                   |
| Mungesa e vendeve të punës në fushën time, Mungesa e njohjeve / rrjetit profesional                          | 1                     | 0.3                   |
| Mungesa e përvojës praktike gjatë studimeve, Mungesa e aftësive praktike apo digjitale të kërkuara nga tregu | 1                     | 0.3                   |
| Mungesa e vendeve të punës në fushën time, Paga të ulëta apo kushte jo të favorshme pune                     | 2                     | 0.5                   |

|   |            |              |
|---|------------|--------------|
| Kërkesat e larta të punëdhënësve për përvojë pune, Konkurrenca e lartë në tregun e punës                                  | 9          | 2.5          |
| Kërkesat e larta të punëdhënësve për përvojë pune, Paga të ulëta apo kushte jo të favorshme pune                          | 3          | 0.8          |
| Konkurrenca e lartë në tregun e punës, Mungesa e aftësive praktike apo digjitale të kërkuara nga tregu                    | 1          | 0.3          |
| Konkurrenca e lartë në tregun e punës, Paga të ulëta apo kushte jo të favorshme pune                                      | 2          | 0.5          |
| Konkurrenca e lartë në tregun e punës, Përputhje e ulët midis studimeve dhe kërkesave të tregut                           | 1          | 0.3          |
| Përputhje e ulët midis studimeve dhe kërkesave të tregut, Mungesa e aftësive praktike apo digjitale të kërkuara nga tregu | 1          | 0.3          |
| Përputhje e ulët midis studimeve dhe kërkesave të tregut, Mungesa e njohjeve / rrjetit profesional                        | 1          | 0.3          |
| Përputhje e ulët midis studimeve dhe kërkesave të tregut, Paga të ulëta apo kushte jo të favorshme pune                   | 3          | 0.8          |
| Mungesa e njohjeve / rrjetit profesional, Mungesa e aftësive praktike apo digjitale të kërkuara nga tregu                 | 1          | 0.3          |
| Mungesa e njohjeve / rrjetit profesional, Paga të ulëta apo kushte jo të favorshme pune                                   | 1          | 0.3          |
| Mungesa e aftësive praktike apo digjitale të kërkuara nga tregu, Paga të ulëta apo kushte jo të favorshme pune            | 1          | 0.3          |
| Më shumë se dy nga sfidat e dhëna   | 131        | 35.9         |
| Tjetër  | 20         | 5.5          |
| <b>Totali</b>   | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e përbëjnë të anketuarit që kanë përjetuar më shumë se dy nga sfidat e dhëna, me 35.9%, duke reflektuar një kompleksitet të lartë të pengesave në procesin e punësimit. Pas kësaj, 11.5% e të anketuarve identifikojnë mungesën e përvojës praktike gjatë studimeve si sfidën kryesore, duke e bërë atë ndër faktorët më dominues. Gjithashtu, 6.8% theksojnë konkurrencën e lartë në tregun e punës, ndërsa 6.3% përmendin mungesën e vendeve të punës në fushën e tyre si pengesë kryesore. Ndërkohë, 5.8% e të anketuarve evidentojnë kërkesat e larta të punëdhënësve për përvojë pune, ndërsa 5.5% përfshihen në kategorinë “Tjetër”, duke reflektuar sfida të ndryshme shtesë që nuk janë specifikuar drejtpërdrejt. Po ashtu, 4.9% e të anketuarve përmendin pagat e ulëta apo kushtet jo të favorshme të punës si sfida të rëndësishme, ndërsa 3.8% theksojnë kombinimin e mungesës së përvojës praktike me kërkesat e larta për përvojë pune.

Ndërkohë, kategoritë e tjera paraqiten me përqindje më të ulëta dhe përfshijnë kombinime të ndryshme të sfidave si mungesa e aftësive praktike apo digjitale, mungesa e rrjetit profesional dhe përputhja e ulët ndërmjet studimeve dhe kërkesave të tregut. Në

përgjithësi, të dhënat tregojnë se sfidat kryesore lidhen me mungesën e përvojës praktike, kërkesat e larta të tregut dhe konkurrencën, shpesh të ndërthurura ndërmjet tyre.

Përgjigjet e përfshira në kategorinë “Tjetër” tregojnë se një pjesë e të anketuarve nuk kanë hasur sfida të konsiderueshme në procesin e punësimit, duke theksuar se kanë qenë të punësuar që gjatë studimeve ose kanë siguruar punë menjëherë pas diplomimit. Kjo sugjeron se për disa individë, integrimi në tregun e punës ka qenë i hershëm dhe relativisht i lehtë, shpesh i lidhur me përvojën paraprake apo vazhdimin e studimeve. Nga ana tjetër, disa përgjigje evidentojnë faktorë të tjerë që ndikojnë në punësim, si vazhdimi i studimeve, largësia gjeografike apo mungesa e informacionit dhe rrjeteve profesionale.

*Tabela 31. Si mund të përmirësojë universiteti mbështetjen për studentët dhe ALUMNI-t në tregun e punës?*

| <b>Si mund të përmirësojë universiteti mbështetjen për studentët dhe ALUMNI-t në tregun e punës?</b>                           | <b>Frekuenca</b> | <b>Përqindja</b> |
|--|------------------|------------------|
| Duke ofruar më shumë praktika profesionale gjatë studimeve   | 60               | 16.4             |
| Duke krijuar bashkëpunime me kompani dhe institucione punëdhënëse  | 20               | 5.5              |
| Përmes organizimit të panairove të karrierës dhe trajnimeve  | 1                | 0.3              |
| Duke forcuar rolin e Qendrës së Karrierës / ALUMNI   | 1                | 0.3              |
| Duke përfshirë më shumë aftësi praktike dhe digjitale në kurrikulë   | 2                | 0.5              |
| Duke ofruar këshillim karriere dhe mentorim për studentët  | 3                | 0.8              |
| Duke zhvilluar rrjete ALUMNI për ndarjen e përvojave profesionale  | 3                | 0.8              |
| Përmes zhvillimit të moduleve të përbashkëta me industrinë   | 3                | 0.8              |
| <b>Të gjitha fushat e dhëna</b>  | <b>39</b>        | <b>10.7</b>      |
| Duke ofruar më shumë praktika profesionale gjatë studimeve, Duke forcuar rolin e Qendrës së Karrierës / ALUMNI                 | 2                | 0.5              |
| Duke ofruar më shumë praktika profesionale gjatë studimeve, Duke krijuar bashkëpunime me kompani dhe institucione punëdhënëse  | 36               | 9.9              |
| Duke ofruar më shumë praktika profesionale gjatë studimeve, Duke ofruar këshillim karriere dhe mentorim për studentët          | 2                | 0.5              |
| Duke ofruar më shumë praktika profesionale gjatë studimeve, Duke përfshirë më shumë aftësi praktike dhe digjitale në kurrikulë | 5                | 1.4              |
| Duke ofruar më shumë praktika profesionale gjatë studimeve, Përmes organizimit të panairove të karrierës dhe trajnimeve        | 2                | 0.5              |
| Duke ofruar më shumë praktika profesionale gjatë studimeve, Përmes zhvillimit të moduleve të përbashkëta me industrinë         | 3                | 0.8              |
| Duke krijuar bashkëpunime me kompani dhe institucione punëdhënëse, Përmes organizimit të panairove të karrierës dhe trajnimeve | 2                | 0.5              |

|  |            |              |
|--|------------|--------------|
| Duke krijuar bashkëpunime me kompani dhe institucione punëdhënëse, Përmes zhvillimit të moduleve të përbashkëta me industrinë  | 2          | 0.5          |
| Duke forcuar rolin e Qendrës së Karrierës / ALUMNI, Duke zhvilluar rrjete ALUMNI për ndarjen e përvojave profesionale          | 1          | 0.3          |
| Duke përfshirë më shumë aftësi praktike dhe digjitale në kurrikulë, Duke ofruar këshillim karriere dhe mentorim për studentët  | 1          | 0.3          |
| Duke përfshirë më shumë aftësi praktike dhe digjitale në kurrikulë, Përmes zhvillimit të moduleve të përbashkëta me industrinë | 1          | 0.3          |
| Duke zhvilluar rrjete ALUMNI për ndarjen e përvojave profesionale, Përmes zhvillimit të moduleve të përbashkëta me industrinë  | 1          | 0.3          |
| Më shumë se dy nga fushat e dhëna  | 168        | 46.0         |
| Tjetër   | 7          | 2.1          |
| <b>Totali</b>  | <b>365</b> | <b>100.0</b> |

Rezultatet tregojnë se përqindjen më të lartë e përbëjnë të anketuarit që propozojnë më shumë se dy forma mbështetjeje njëkohësisht, me 46.0%, duke reflektuar nevojën për një qasje të integruar nga universiteti në përgatitjen dhe mbështetjen e studentëve dhe ALUMNI-t në tregun e punës. Pas kësaj, 16.4% e të anketuarve theksojnë rëndësinë e ofrimit të më shumë praktikave profesionale gjatë studimeve, duke e identifikuar atë si një nga elementet më kyçe për rritjen e punësueshmërisë. Po ashtu, 10.7% konsiderojnë se të gjitha fushat e përmendura janë të rëndësishme për përmirësim, ndërsa 9.9% veçojnë kombinimin e praktikave profesionale me krijimin e bashkëpunimeve me kompani dhe institucione punëdhënëse.

Ndërkohë, 5.5% e të anketuarve theksojnë vetëm bashkëpunimin me kompani dhe institucione si një mekanizëm të rëndësishëm për mbështetje në tregun e punës. Një pjesë më e vogël, përkatësisht 2.1%, përfshihet në kategorinë “Tjetër”, duke reflektuar sugjerime të ndryshme shtesë. Përgjigjet e përfshira në kategorinë “Tjetër” ofrojnë një perspektivë më kritike dhe më konkrete mbi mënyrën se si universiteti mund të përmirësojë mbështetjen për studentët dhe ALUMNI-t në tregun e punës. Vihet në pah nevoja për rritjen e cilësisë dhe vlerës së praktikave profesionale, duke sugjeruar që ato të shoqërohen me kontribute formale (p.sh. përvojë e njohur ligjërimit), në mënyrë që të kenë ndikim real në zhvillimin profesional të studentëve. Kjo lidhet drejtpërdrejt me rritjen e besueshmërisë dhe vlerësimit të përvojës praktike në tregun e punës. Nga ana tjetër, disa përgjigje vlerësojnë pozitivisht rolin orientues të Qendrës së Karrierës, duke sugjeruar që zgjerimi i aktiviteteve dhe mundësive të ofruara do të ndikonte në përgatitjen më të mirë të studentëve për karrierë. Po ashtu, përmendet rëndësia e krijimit të mundësive për angazhim të studentëve të dalluar në mësimdhënie, si një mënyrë për zhvillim profesional dhe integrim më të lehtë në tregun e punës. Në përgjithësi, këto

mendime theksojnë nevojën për kalimin nga qasjet formale drejt zbatimit praktik dhe efektiv të mekanizmave mbështetës, duke forcuar lidhjen ndërmjet universitetit dhe tregut të punës.

Kategoritë e tjera paraqiten me përqindje më të ulëta dhe përfshijnë kombinime të ndryshme të masave si këshillimi për karrierë, mentorimi, zhvillimi i rrjeteve ALUMNI, përfshirja e aftësive praktike dhe digjitale në kurrikulë, si dhe organizimi i panairove të karrierës dhe bashkëpunimi me industrinë. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se theksi kryesor vihet në përforsimin e komponentit praktik dhe ndërtimin e lidhjeve më të forta me tregun e punës, të kombinuara me mbështetje institucionale më të strukturuar.

Në fund të pyetësorit, të anketuarit patën mundësinë që të japin komente apo sugjerime shtesë. Komentet dhe sugjerimet e të diplomuarve reflektojnë një vlerësim përgjithësisht pozitiv ndaj përvojës së tyre akademike në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, duke e konsideruar atë si një bazë të rëndësishme për zhvillimin profesional dhe ndërtimin e një karriere të qëndrueshme. Shumë prej tyre theksojnë se studimet në këtë institucion u kanë mundësuar përfitimin e njohurive të vlefshme, zhvillimin personal dhe profesional, si dhe krijimin e një perspektive më të qartë për tregun e punës.

Një ndër temat më të theksuara në sugjerimet e të diplomuarve është nevoja për fuqizimin e mëtejshëm të komponentës praktike në procesin mësimor. Ata rekomandojnë rritjen e numrit dhe cilësisë së praktikave profesionale, përfshirë mundësinë e realizimit të praktikave të strukturuar dhe të mbështetura institucionalisht, të cilat do të kontribuonin drejtpërdrejt në përgatitjen më të mirë të studentëve për sfidat reale të tregut të punës. Në këtë drejtim, vlerësohet gjithashtu rëndësia e integritit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si analizat e rasteve konkrete, simulimet profesionale dhe përdorimi i teknologjisë në mësim.

Të diplomuarit theksojnë gjithashtu rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe sektorit publik e privat. Sipas tyre, zgjerimi i partneriteteve me biznese, institucione dhe organizata të ndryshme do të krijonte më shumë mundësi për praktika, punësim dhe zhvillim profesional. Po ashtu, zhvillimi i rrjeteve funksionale ALUMNI dhe organizimi i aktiviteteve si takime, trajnime dhe prezantime nga ish-studentë të suksesshëm konsiderohen si mekanizma efektivë për orientimin në karrierë dhe shkëmbimin e përvojave.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që del nga komentet është nevoja për përshtatjen e vazhdueshme të programeve të studimit me kërkesat dinamike të tregut të punës. Të diplomuarit sugjerojnë që kurrikulat të përfshijnë më shumë aftësi praktike, digjitale dhe profesionale, duke reduktuar hendekun ndërmjet teorisë dhe praktikës. Kjo qasje do të

ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e punësueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së të diplomuarve.

Në përgjithësi, këto komente përfaqësojnë një qasje konstruktive dhe mbështetëse ndaj zhvillimit të mëtejshëm të universitetit, duke synuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përmirësimin e shërbimeve për studentët dhe forcimin e lidhjes me tregun e punës. Sugjerimet e dhëna paraqesin një bazë të vlefshme për avancimin strategjik të institucionit dhe për rritjen e ndikimit të tij në zhvillimin profesional të gjeneratave të ardhshme.

**KONKLUZIONE  
DHE  
REKOMANDIME**

Bazuar në rezultatet e hulumtimit mbi punësueshmërinë e të diplomuarve të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, mund të nxirren disa konkluzione të rëndësishme që reflektojnë gjendjen aktuale të integritit të tyre në tregun e punës dhe faktorët që ndikojnë në këtë proces.

Së pari, të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve janë të punësuar, ku dominon punësimi me kohë të plotë, ndërsa një përqindje më e vogël mbetet ende në kërkim të punës. Kjo sugjeron se universiteti ka një ndikim pozitiv në përgatitjen e studentëve për tregun e punës, megjithatë ekziston ende një hendek i dukshëm për një segment të të diplomuarve që hasin vështirësi në punësim. Gjithashtu, vërehet se një numër i konsiderueshëm i studentëve kanë qenë të punësuar që gjatë studimeve, çka tregon për një nivel të caktuar të integritit të hershëm në tregun e punës.

Së dyti, lidhja ndërmjet fushës së studimit dhe punës aktuale paraqitet e pjesshme, pasi një pjesë e të diplomuarve punojnë në fusha të ndryshme nga ajo për të cilën janë diplomuar. Kjo tregon për një fleksibilitet të të diplomuarve në tregun e punës, por njëkohësisht edhe për një mospërputhje ndërmjet programeve studimore dhe kërkesave reale të tregut. Ky fenomen është i lidhur edhe me sfidat e identifikuar, si mungesa e përvojës praktike gjatë studimeve dhe kërkesat e larta të punëdhënësve për përvojë pune.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me rëndësinë e përvojës praktike. Rezultatet tregojnë se praktikat profesionale dhe përvoja gjatë studimeve kanë rol kyç në rritjen e punësueshmërisë. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve nuk kanë pasur mundësi të mjaftueshme për praktika, duke e bërë këtë një nga sfidat kryesore në tranzicionin drejt tregut të punës. Në të njëjtën kohë, ata që kanë ndjekur praktika i kanë vlerësuar ato si shumë të dobishme për përgatitjen profesionale.

Nga aspekti i aftësive, të diplomuarit theksojnë rëndësinë e kombinimit të aftësive analitike, komunikuese, digjitale dhe menaxheriale, si më të kërkuarat në tregun e punës. Po ashtu, aftësitë praktike dhe përdorimi i teknologjisë janë ndër më të përdorurat në punë, duke nënvizuar nevojën për një qasje më të orientuar drejt praktikës në procesin mësimor.

Për më tepër, rezultatet tregojnë se shumica e të diplomuarve vlerësojnë pozitivisht përgatitjen profesionale të fituar gjatë studimeve dhe do ta rekomandonin programin e tyre të studimit tek të tjerët. Kjo reflekton një nivel të kënaqshëm të cilësisë së mësimdhënies, megjithëse ekziston hapësirë për përmirësim në aspektin e lidhjes me praktikën dhe tregun e punës.

Sa i përket kushteve të punës, të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të diplomuarve kanë të ardhura mbi mesataren dhe e konsiderojnë marrëdhënien e tyre të punës si të qëndrueshme, çka sugjeron një nivel relativisht të mirë të integritit në tregun e punës për ata që janë të punësuar.

Në përfundim, hulumtimi evidenton se Universiteti “Haxhi Zeka” ka një rol të rëndësishëm në përgatitjen e studentëve për tregun e punës, por gjithashtu thekson nevojën për përmirësime të mëtejshme, veçanërisht në drejtim të rritjes së komponentit praktik, forcimit të bashkëpunimit me sektorin privat dhe publik, si dhe zhvillimit të aftësive që kërkohen nga tregu bashkëkohor i punës.

Duke u bazuar në gjetjet e këtij hulumtimi, rekomandohet që Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë të intensifikojë përpjekjet për integrimin e komponentës praktike në procesin mësimor. Kjo mund të arrihet përmes rritjes së numrit dhe cilësisë së praktikave profesionale, duke siguruar që ato të jenë të strukturuar, të mbikëqyrura dhe të lidhura drejtpërdrejt me fushat e studimit.

Një tjetër rekomandim i rëndësishëm lidhet me forcimin e bashkëpunimit ndërmjet universitetit dhe sektorit privat dhe publik. Krijimi i partneriteteve strategjike me biznese, institucione dhe organizata të ndryshme do të mundësonte më shumë mundësi për praktika, punësim dhe zhvillim profesional për studentët dhe të diplomuarit.

Gjithashtu, rekomandohet përditësimi i vazhdueshëm i kurrikulave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, me fokus të veçantë në zhvillimin e aftësive praktike, digjitale dhe ndërdisiplinore. Integrimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies, si analizat e rasteve, simulimet dhe projektet praktike, do të kontribuonte në përgatitjen më të mirë të studentëve.

Në funksion të mbështetjes së karrierës, rekomandohet fuqizimi i rolit të Qendrës së Karrierës dhe zhvillimi i rrjeteve funksionale ALUMNI, të cilat do të shërbenin si ura lidhëse ndërmjet universitetit dhe tregut të punës. Po ashtu, organizimi i trajnimeve, mentorimeve dhe aktiviteteve orientuese do të ndihmonte studentët në zhvillimin e aftësive të kërkuara dhe në orientimin e tyre profesional.

Së fundi, rekomandohet promovimi i një qasjeje më aktive në zhvillimin profesional të studentëve, duke inkurajuar pjesëmarrjen në trajnime, projekte dhe aktivitete jashtëkurrikulare. Kjo do të kontribuonte në rritjen e konkurrueshmërisë së të diplomuarve dhe në përmirësimin e mundësive të tyre për punësim në tregun e punës.

# SHTOJCË

## PYETËSOR PËR PUNËSUESHMËRINË DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË TË DIPLOMUARVE (ALUMNI)

Ky hulumtim synon të analizojë gjendjen aktuale të punësimit të të diplomuarve dhe përputhjen e kompetencave të fituara gjatë studimeve me kërkesat e tregut të punës, me qëllim të përmirësimit të programeve akademike dhe mbështetjes për karrierë.

### I. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

1. Emri dhe mbiemri (opsionale): \_\_\_\_\_
2. Gjinia:
  - F
  - M
3. Viti i diplomimit: \_\_\_\_\_
4. Niveli i studimeve të përfunduara:
  - Bachelor
  - Master
5. Programi i studimeve / Departamenti: \_\_\_\_\_
6. Vendi aktual i banimit:
  - Brenda vendit
  - Jashtë vendit – specifikoni shtetin: \_\_\_\_\_

### II. STATUSI I PUNËSIMIT

#### 7. Statusi aktual i punësimit:

- I punësuar me kohë të plotë
- I punësuar me kohë të pjesshme
- I vetëpunësuar
- I papunë dhe në kërkim pune
- Vazhdon studimet
- Tjetër (specifikoni): \_\_\_\_\_

#### 8. Sa kohë pas diplomimit e keni gjetur punën e parë?

- Brenda 3 muajve
- Brenda 6 muajve
- Brenda 1 viti
- Pas më shumë se 1 viti
- Isha i punësuar gjatë studimeve
- Ende nuk kam punuar pas diplomimit
- Nuk kam kërkuar ende punë

**9. Lloji i institucionit ku punoni aktualisht:**

- Sektor publik
- Sektor privat
- Organizatë ndërkombëtare
- OJQ
- Biznes personal
- Tjetër: \_\_\_\_\_

**10. Pozita juaj aktuale (titulli i vendit të punës):** \_\_\_\_\_

**11. Emri i organizatës / institucionit / ndërmarrjes:** \_\_\_\_\_

**12. A është puna juaj aktuale në fushën për të cilën keni diplomuar?**

- Po, plotësisht
- Pjesërisht
- Jo, në një fushë tjetër: \_\_\_\_\_

**III. PËRPUTHJA E STUDIMEVE ME TREGUN E PUNËS**

**13. Sa i rëndësishëm ishte niveli i arsimit tuaj universitar për të siguruar punën aktuale?**

- Shumë i rëndësishëm
- Mjaft i rëndësishëm
- Pak i rëndësishëm
- Aspak i rëndësishëm

**14. Sa e vlerësoni përgatitjen profesionale që keni fituar gjatë studimeve?**

- Shumë të mirë
- Të mirë
- Mesatare
- Të dobët

**15. Në cilat fusha mendoni se universiteti mund të përmirësohet për të rritur punësueshmërinë e studentëve?**

- Praktikat profesionale
- Bashkëpunimi me bizneset
- Përmbajtja e kurrikulës
- Aftësitë digjitale
- Aftësitë komunikuese dhe menaxheriale
- Tjetër: \_\_\_\_\_

**16. A keni marrë pjesë në ndonjë praktikë profesionale gjatë studimeve?**

- Po
- Jo
- Nëse po, sa e dobishme ishte për përgatitjen tuaj profesionale?
- Shumë e dobishme
- Pjesërisht e dobishme
- Jo e dobishme

**IV. ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE PLANET E ARDHSHE**

**17. A keni ndjekur ndonjë trajnim / kurs pas diplomimit?**

- Po
- Jo
- Nëse po, në cilën fushë? \_\_\_\_\_

**18. A planifikoni të vazhdoni studimet e mëtejshme (Master / PhD)?**

- Po
- Jo
- Ndoshta në të ardhmen

**19. Cilat aftësi mendoni se janë më të kërkuara nga punëdhënësit në fushën tuaj ("Zgjidhni deri në 3 opsione")?**

- aftësi analitike
- komunikim
- teknologji
- menaxhim projektsh
- tjetër: \_\_\_\_\_

**V. KOMENTE TË TJERA**

**20. Cilat janë sfidat kryesore që keni hasur për t'u punësuar?**

- Mungesa e përvojës praktike gjatë studimeve
- Mungesa e vendeve të punës në fushën time
- Kërkesat e larta të punëdhënësve për përvojë pune
- Konkurrenca e lartë në tregun e punës
- Përputhje e ulët midis studimeve dhe kërkesave të tregut
- Mungesa e njohjeve / rrjetit profesional
- Mungesa e aftësive praktike apo digjitale të kërkuara nga tregu
- Paga të ulëta apo kushte jo të favorshme pune
- Tjetër (specifikoni): \_\_\_\_\_

**21. Si mund të përmirësojë universiteti mbështetjen për studentët dhe ALUMNI-t në tregun e punës?**

- Duke ofruar më shumë praktika profesionale gjatë studimeve
- Duke krijuar bashkëpunime me kompani dhe institucione punëdhënëse
- Përmes organizimit të panairove të karrierës dhe trajnimeve
- Duke forcuar rolin e Qendrës së Karrierës / ALUMNI
- Duke përfshirë më shumë aftësi praktike dhe digjitale në kurrikulë
- Duke ofruar këshillim karriere dhe mentorim për studentët
- Duke zhvilluar rrjete ALUMNI për ndarjen e përvojave profesionale
- Përmes zhvillimit të moduleve të përbashkëta me industrinë
- Tjetër (specifikoni): \_\_\_\_\_

**22. Komente apo sugjerime të tjera:**

---

---